



Republika e Kosovës



Komuna e Kaçanikut

Republika Kosova



REPUBLIKA E KOSOVË S
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Opština Kaçanik

Republic of Kosovo

Municipal Kaçanik

I	Data	04.04.2025	Vendi	Kaçanik
Nj. org.	Numri	Shtojcë		
	10-104/02-	7383/25		

DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK DHE TURIZËM

THIRRJE PËR APLIKIM NË PROGRAMIN

“SUBVENCIONIMI I BIZNESEVE START-UP 2025”

Afati për aplikim:

Nga data **04.04.2025** deri më **28.04.2025** ora **16:00**

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm (DZHET) në Komunën e Kaçanikut, në bazë të nenit 16 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve në Komunën e Kaçanikut me Nr.06/2016, shpall këtë thirrje për aplikim në kuadër të Programit "Subvencionimi i Bizneseve START-UP".

Qëllimi i Programit "Subvencionimi i Bizneseve START-UP", ka për synim fuqizimin ekonomik në komunën e Kaçanikut, përkatësisht përkrahjen e bizneseve fillestare si dhe rritjen e numrit të bizneseve të reja.

Shuma e fondit në dispozicion për këtë thirrje është 51,000.00 €.

Vlera maksimale e bashkëfinancimit të një granti është 3,750.00 €.

Përqindja e bashkëfinancimit nga aplikantët duhet të jetë 20%, kurse shuma që kërkohet nga Komuna e Kaçanikut nuk mund të jetë mbi 80% e kostos totale të projekt propozimit (*pra shuma e bashkëfinancimit nga ana e komunës nuk mund të kaloj vlerën 3,000.00 € dhe kosto totale e projekt propozimit nuk duhet të kaloj vlerën 3,750.00 €*), ndërsa shuma e bashkëfinancimit të bizneseve nuk duhet të jetë më e lartë se 750.00 €.

KRITERET E APLIKIMIT

1. Regjistrimi i biznesit duhet të bëhet para nënshkrimit të kontratës. Bizneset duhet të jenë të regjistruara në Zyrën për Regjistrimin e Bizneseve në Komunën e Kaçanikut;
2. Të jetë biznes që operon në Komunën e Kaçanikut, ku edhe do të bëhet investimi;
3. Të gjenerojë punësim me marrjen e grantit. Biznesi duhet të punësojë së paku një punonjës me marrjen e grantit. Punësimi i më tepër se një punonjësi për biznesin konsiderohet përparësi;
4. Pronari/ja i/e biznesit duhet të jetë banor i Komunës së Kaçanikut;
5. Bizneset të cilat promovojnë ide kreative dhe inovative në tregun tonë do të kenë përparësi.

ÇFARË FINANCOHET NGA GRANTI?

Blerja e pajisjeve dhe mjeteve të punës (Pajisjet duhet të jenë të reja).

Investime në asete të prekshme që kanë të bëjnë me blerjen e pajisjeve, makinerisë, linjat e prodhimit, që mund t'i ndihmojnë kompanive të jenë funksionale në treg.

KRITERET JO KUALIFIKUESE

Aplikantët potencialë nuk mund të marrin pjesë në këtë thirrje apo të përfitojnë grant nëse gjenden në ndonjërin prej situatave që renditen si më poshtë:

1. Bëjnë pjesë në njërin prej veprimtarive si: tregtia (me pakicë dhe shumicë, në kuptimin e shit-blerjes), ndërtimtaria, shëndetësia dhe bujqësia;
2. Paraqet veti diskriminuese apo ka ndikim negativ në shoqëri dhe komunitet;
3. I shkakton dëme ambientit apo ndonjë grupi tjetër të marginalizuar;

DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM

1. Formulari i Aplikimit, (Shtojca A);
2. Buxheti dhe burimet e financimit, (Shtojca B);
3. Kopja e dokumentit identifikues personal valid i lëshuar nga Republika e Kosovës;
4. Oferta (Profatura) për pajisjet/makineritë e planifikuara në projekt (*oferta duhet të përmbajë të dhëna të sakta të ofruesit në ofertë dhe të dhëna të sakta të marrësit të ofertës, gjithashtu oferta nuk duhet të jetë më e vjetër se data e shpalljes së kësaj thirrje*).

Sqarim:

1. Ofertat duhet të jenë vetëm në valutën EURO;
2. Dokumentet e listuara më lartë duhet të jenë me dukshmëri të qartë;
3. Dokumentet për aplikim mund të shkarkohen nga web faqja zyrtare e Komunës së Kaçanikut.

PROCEDURAT E VLERËSIMIT

Faza e parë e vlerësimit të aplikacioneve do të përfshijë një “kontroll administrativ” për të siguruar që aplikantët kanë përmbushur rregullat e kualifikimit dhe dokumentet e kërkuara për aplikim. Faza e dytë përfshinë vlerësimin përmbajtësor të aplikimit, duke u bazuar në kriteret përzgjedhëse dhe nëse ndërmarrja ka perspektivë të mirë të të qenët e suksesshme dhe e qëndrueshme, si dhe implementimi do të kontribuojë përmbushjes së qëllimit të thirrjes.

Vlerësimi bëhet me poentim nga Komisioni Komunal, duke u bazuar në tabelën e më poshtme, e cila rrjedh nga qëllimet e kësaj thirrjeje.

	Pikët
Ideja e biznesit dhe inovacioni	Totali(35 pikë)
Idetë inovative	10 pikë
Potenciali për eksport	10 pikë
Bizeset prodhuese dhe përpunuese	10 pikë
Potenciali për adresimin e një nevoje ose një problemi real	5 pikë
Potenciali i tregut dhe përvoja e aplikuesit	Totali(25 pikë)
Madhësia e tregut dhe potenciali i rritjes	10 pikë
Avantazhi konkurrues dhe diferencimi	10 pikë
Përvoja dhe aftësitë përkatëse të aplikuesit	5 pikë
Qëndrueshmëria financiare	Totali(20 pikë)
Parashikime financiare realiste dhe të realizueshme	10 pikë
Potenciali për përfitim dhe qëndrueshmëri afatgjate	10 pikë
Ndikimi social dhe mjedisor	Totali(20 pikë)
Aplikuesi/ja është me aftësi të kufizuara	8 pikë
Aplikuesi/ja është i gjinisë femërore	7 pikë
Projekti ka ndikim pozitiv në ambient	5 pikë
	TOTALI : 100 Pikë

Kalueshmëria e projektit është mbi 60 pikë.

NËNSHKRIMI I KONTRATËS DHE ANKESAT

Komuna Kaçanikut do të themelojë komision të pavarur dhe profesional për vlerësimin e aplikacioneve. Pas shqyrtimit të aplikacioneve do të bëhet publikimi i listës preliminare. Pas publikimit të rezultateve preliminare, aplikantët e pakënaqur mund të adresojnë ankesa në Qendrën për Shërbim me Qytetarë në Komunën e Kaçanikut brenda 5 ditëve nga data e publikimit të rezultateve. Pas shqyrtimi të ankesave do të bëhet publikimi i listës finale të përfituesve dhe do të bëhet nënshkrimi i kontratave me përfitues.

Pas përzgjedhjes së përfituesve dhe para nënshkrimit të kontratës, janë të nevojshme këto dokumente:

- 1. Konfirmimi nga banka për xhirollogarinë bankare;**
- 2. Certifikata e Biznesit me informatat përcjellëse.**

FORMA E PAGESËS SË GRANTIT

Shuma e financimit të fondeve publike komunale për grante ndahet në:

Maksimumi nga 3,000.00€.

Grantet jepen në formën e transferit të mjeteve financiare, pasi që aplikuesi (biznesi) të sjellë dëshminë respektivisht faturën e rregullt për blerjet (investimet) që i ka bërë, të cilat duhet të jenë në përputhshmëri të plotë me kërkesën për investim që e ka dëshmuar me profaturë/ofertë.

Profatura që aplikuesi paraqet gjatë aplikimit dhe fatura e rregullt që i njëjti e merr pasi të ketë blerë pajisjen duhet të ketë përputhshmëri të plotë njëra me tjetrën, në asnjë formë nuk lejohet ndryshimi i specifikave të pajisjes.

PROCEDURAT PËR APLIKIM

Aplikacionet duhet të plotësohen në formë kompjuterike duke mos ndryshuar formatin e aplikacioneve të dizajnuara nga Komuna e Kaçanikut për këtë thirrje.

Aplikacionet e shkruara me dorë nuk do të pranohen.

Vetëm formularët e plotësuar me të gjitha informatat relevante në lidhje me veprimtarinë, do të kalojnë për vlerësim.

Në rastet kur ka mos përputhje të vlerave buxhetore në projekt, konfuzitet në përshkrim të projektit dhe gabim në përdorimin e formateve të përcaktuara në thirrjen për propozime, projekti do të s'kualifikohet.

Komuna Kaçanikut nuk është përgjegjëse për koston që ndërlihet me përgatitjen e aplikacionit dhe se këto shpenzime nuk janë të pranueshme nëse përfshihen në projekt.

Pakoja e Aplikimit mund të merret duke klikuar në web-faqen zyrtare të komunës në linkun: <https://kacanik.rks-gov.net/shpalljet/?tax=thirrje-per-propozime>

Periudha e aplikimit do të jetë e hapur nga data **04.04.2025** deri më **28.04.2025**.

Sqarim:

Në rast se jeni përzgjedhur përfitues i grantit, nënshkruhet marrëveshja me Komunën/DZHET dhe pastaj duhet të sjellët **Fatura dhe transferi bankar** i bërë nga xhirollogaria e përfituesit (biznesit) tek operatori ekonomik (furnitori), me të cilën dëshmohet blerja e pajisjes/ve dhe pastaj Komuna e bënë rimbursimin e mjeteve financiare në vlerën e grantit.

Gjatë kësaj faze komisioni i Komunës së Kaçanikut do të vizitojë vendet ku biznesi zhvillon aktivitetet dhe do të verifikojë nëse gjendja e aplikuesit në terren është në përputhje me projekt-propozimin e dorëzuar.

Nëse nuk ka përputhshmëri në mes të projekt-propozimit dhe gjendjes në terren, projekt-propozimi do të anulohet.

Kohëzgjatja e planifikuar e zbatimit nuk mund të tejkalojë 2 muaj.

Vërejtje:

Nga momenti i nënshkrimit të marrëveshjes me secilin përfitues, përfituesi është i obliguar që t'i përmbahet kushteve të marrëveshjes, vlen të cekët që përfituesi nuk ka të drejtë që pajisjen ta ndërroj, shesë apo të huazoj tek pala tjetër në afat kohor prej 3 vite duke filluar nga data e nënshkrimit të marrëveshjes.

Pas nënshkrimit të marrëveshjes me secilin përfitues, formohet komisioni nga ana e Komunës së Kaçanikut, komisioni i cili monitoron gjendjen faktike në teren dhe në rast të keqpërdorimit eventual do të ndiqen rrugët ligjore.

Drejtoreshë në DZHET
Pranverë Loku Zharku

